



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:272701
Datë: 05.02.2024
Numri i dokumentit: 05287090

KPPP.nr. 441/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, kundër debitorit N.T.SH “Shpejtimi”, me seli në Suharekë, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbartim, jashtë seancës, me datë 05.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren, Dega Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm për të vendosur në çështjen juridike përmbartimore në mes të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me seli në Prishtinë, dhe debitorit N.T.SH “Shpejtimi”, me seli në Suharekë.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” Sh.A., me aktvendimin 473/12, të datës 14.08.2012, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit N.T.SH “Shpejtimi”, për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej EUR 161.89. Ndërsa, kjo gjykatë me aktvendimin E.nr.

473/12, të datës 14.04.2016, është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Themelore në Prizren, Dega Suharekë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbartimore.

Gjykata Themelore në Prizren, Dega Suharekë, me Aktvendimin CP.nr. 523/18, të datës 27.12.2022, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhoma të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhoma të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Prizren, Dega Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, për arsye si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbartimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhoma të Shkallës së Parë dhe Dhoma të Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbartimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbartimit sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedure përmbartimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-

së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është caktimi dhe zbatimi i përmbarimit nga gjykata si organ përmbarues sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Prizren, Dega Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVOËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 441/23, datë 05.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.